



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.11.2020, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rend i ditës

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për prokurimin publik”.
2. Të tjera.

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Klodiana Spahiu, Nikolin Staka,, Fatmir Velaj,, Kostaq Papa, Vasil Sterjovski, Arlind Çaçani, Edlira Hyseni, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Ralf Gjoni, Artemis Dralo(zëvendësuese

Mungojnë:

Arben Kamami, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Sadri Abazi,

Të ftuar:

Reida Kashta - drejtor i përgjithshëm i Agjencisë së Prokurimit Publik

Xhoana Ristani - përgjegjëse e sektorit të integritetit në Agjencinë e Prokurimit Publik

Joanid Myzyri - Kryetar i Komisionit të Prokurimit Publik.

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Përshëndetje e mirëdita, të nderuar kolegë!

Fillojmë mbledhjen.

Sot jemi mbledhur për të shqyrtuar edhe një herë projektligjin “Për prokurimin publik”.

Edhe një herë dua të falënderoj për pjesëmarrjen zonjën Kashta dhe zonjën Ristani, që ndodhen në linjë.

Thjesht për kujtesë, ne sot po mblidhemi sërish për të sheshuar pak debatin apo keqkuptimin që patëm radhën e kaluar, në mënyrë që opinionet tona të rakordojmë sa më shumë me APP-në, por edhe me drejtorinë që është këtu, Drejtorinë e Përafrimit të Legjislacionit me BE-në.

Pa humbur shumë kohë, do të doja ta fillonim me zotin Kasneci, e më pas të vijonim me zonjën Kashta.

Por më parë, kam si detyrim të marr listëprezencën. Fillojmë:

Zonja Mesi, e pranishme.

Zoti Velaj! Më thoni: po ose jo.

Vetëm se, ju lutem, duhet t’ju dëgjojmë. Disa prej jush i kanë hapur kamerat, disa jo.

Zoti Ulqini!

Musa Ulqini – Këtu!

Rudina Hajdari – Zoti Balla!

Zoti Kamani!

Zonja Spahiu!

Zonja Kumbaro!

Zoti Abazi!

Zoti Staka!

Nikolin Staka – Prezent!

Rudina Hajdari – Zoti Papa!

Zonja Hyseni!

Zoti Çaçani!

Zoti Sterjovski!

Vasil Sterjovski – Prezent!

Rudina Hajdari – Zonja Malo!

Besoje se e kemi kuorumin për të vazhduar mbledhjen, ndaj le të fillojmë me zotin Kasneci.

Zoti Kasneci, fjala është për ju!

Dedë Kasneci – Përshëndetje të gjithëve!

E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë!

E nderuara zonja Kashta!

Në zbatim të detyrës, zonja kryetare dhe të nderuar deputetë, që ju na latë në mbledhjen e fundit të Komisionit të Integritimit, menjëherë pas mbledhjes, unë, zonja Kashta dhe stafi i saj kemi diskutuar që të dakordësoheshim në lidhje me formulimin e pikës 2 të nenit 127 të ligjit “Për prokurimin publik”.

Në pikën 2 të nenit 127 të projektligjit, shprehja: “Vlera totale e modifikimit të kontratës apo marrëveshjes kuadër nuk duhet të tejkalojë 20 % të vlerës së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër.”, është zëvendësuar me shprehjen: “Çdo rritje në çmim nuk duhet të tejkalojë 20 % të vlerës së kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër.”

Nëse është e nevojshme, zonja kryetare, mund të lexoj edhe formulimin total, por në vlerësimin tim nuk është e nevojshme, pasi situata është e qartë.

Ky riformulim i dakordësuar për pikën 2 të nenit 127 të projektligjit “Për prokurimin publik” qartëson dhe saktëson se kufiri tavan prej 20 % lidhet me rritjen e çmimit, krahasuar me çmimin e kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër dhe jo në vlerën totale të modifikimit të kontratës fillestare apo të marrëveshjes kuadër, siç ishte në tekstin e projektligjit, për afron plotësisht kriterin e parashikuar në nenin e direktivës së BE-së, ku për ndryshime jothelbësore lejohet rishikimi i çmimit deri në 50 %. Pra, ligji është në përputhje të plotë deri në 20 %.

Saktësimi i kësaj pike, e nderuara zonja kryetare dhe të nderuar deputetë, pra i pikës 2 të nenit 127, jep efekt ose mundëson që pika 5 e nenit 127 të projektligjit të për afrojë plotësisht kërkesën tjetër të direktivës, dhe kërkesa tjetër e direktivës është: “Kur ndryshimet janë jothelbësore, por edhe thelbësore, legjislacioni i BE-së e lejon rishikimin e kontratës, nëse vlera totale e rishikimit nuk kalon 10 %, e përshkallëzuar për kontratat e mallrave e të shërbimeve, dhe 15 % për kontratat e punës dhe marrëveshjet kuadër.”

Pika 5 e nenit 127 të projektligjit është formuluar si vijon: “Për modifikimin e dispozitave të kontratës publike apo të marrëveshjeve kuadër, gjatë kohëzgjatjes së saj, të cilat nuk mbulohen nga pika 1 e projektligjit, autoriteti ose enti kontraktor ka si detyrim të zhvillojë një procedurë të re prokurimi, në përputhje me këtë ligj.”

Pra, ndërsa dy direktivat e BE-së lejojnë që për ndryshime thelbësore ose jo, po për ndryshime thelbësore, që kontrata fillestare të ndryshojë, por me kushtin që të respektohet

kufiri monetar, të respektohet edhe kufiri tjetër, që ndryshimet në vlerën totale të mos jenë më shumë se 10 % - 15 %, projektligji, pra pika 5 e ndalon totalisht. Kjo është në përputhje të plotë me nenet përkatës të direktivës. Pra, ky parashikim është në përputhje të plotë me kërkesat e direktivës së BE-së, që e lejojnë ndryshimin e kontratës fillestare edhe kur ndryshimi është thelbësor, kur hartohet thelbësisht ndryshe, me kushtin që të respektohet kufiri 10 % - 15 %.

Si përfundim, e nderuara zonja kryetare dhe të nderuar deputetë, me riformulimin e pikës 2 të nenit 127, projektligji është në përputhje të plotë me të gjitha kërkesat që parashikon neni 72 i direktivës së BE-së në sektorin klasik dhe me nenin 89 të direktivës, në ato që janë uji, energjia, posta, të cilat janë shërbime publike.

Projektligji do të lejojë vetëm amendime jothelbësore të kontratave fillestare, që shoqërohen me rritje çmimi deri në 20 %, ndërkohë që direktiva e ka që lejohet rishikimi i çmimit deri në 50 %. Së dyti, çdo ndryshim tjetër në kontratë, i cili është thelbësor ose jo, duhet të riprokurohet, ndërkohë që direktiva lejon që edhe për ndryshime thelbësore bëhet rishikimi i kontratës fillestare pa një procedurë të re prokurimi, kur vlerat janë 10 % - 15 %.

Si përfundim, zonja kryetare, në vlerësimin tonë ky saktësim ishte shumë i nevojshëm, sepse koncepti i modifikimit të kontratës parashikohet për herë të parë në legjislacionin shqiptar. Prandaj ishte shumë e nevojshme që formulimet të ishin të sakta, të qarta dhe në linjë me parashikimet e direktivës.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kasneci!

Zonja Kashta, fjala është për ju!

Reida Kashta – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë!

Sikurse e parashitroi edhe zoti Kasneci, ne e mbajmë nenin përkatës 127, pika 2, sikurse e kishim parashikuar, me vlerën 20 %, siç ishte diskutimi, e që e kemi ndryshe nga direktiva, e cila e ka 50 %. Po ashtu, ndryshuam, u dakordësuam në lidhje me ndryshimin e terminologjisë nga vlera totale e kontratës në çmimin e vlerës totale të kontratës, për të qenë motamo ashtu siç e parashikon direktiva, pavarësisht se teknikisht dhe nga pikëpamja e procedurës së prokurimit, përfundimi është njëlloj, ajo ndikon në rritjen e vlerës së kontratës.

Megjithatë, në diskutimet që bëmë me zotin Kasneci, u dakordësuam që t'i rrimë parashikimit të fjalëve sipas direktivës, dhe jemi në këtë parashikim konkret të dakordësuar, të cilin e miratojmë dhe besoj se s'kemi diskutime mbi nenin.

Edhe çështja që u ngrit në mbledhjen e kaluar në lidhje me mundësinë e abuzimit të autoritet dhe kontraktore për të lidhur shtesa kontratash deri në 100% e gjen zgjidhjen në pikën

5 të këtij neni, që nuk lejon asnjë lloj amendimi përveç amendimit në vlerën 20%, përndryshe çdo autoritet kontraktor duhet të shkojë në riprokurim. Pra, ne lejojmë vetëm një kategori amendimi, 20% të vlerës, vetëm nëse plotësojnë kushtet.

Kategoritë e tjera, që i lejon direktiva edhe pa kushte, edhe në masa më të mëdha, nuk lejohen nga legjislacioni ynë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Kashta!

Faleminderit, zoti Kasneci, që arritët në një dakordësi në lidhje me këtë nen! Besoj se tani që ju keni rënë dakord, anëtarët e Komisionit të Integritetit do ta votojnë këtë projektligj, por nëse ka pyetje nga deputetë për zotin Kasneci ose për zonjën Kashta, tani është momenti që mund t'i drejtoni pyetje.

Urdhëroni, zoti Gjoni!

Ralf Gjoni - Faleminderit!

Ju kërkohet ndjesë sepse jam në lëvizje dhe nuk e di a dëgjohem!

Kam vetëm një koment dhe pyetje për zonjën Kashta.

Falenderoj zotin Kasneci dhe zonjën Kashta! Ky bashkëpunim mes jush provon që vendimi ynë për të shtyrë mbledhjen ishte i drejtë dhe që Komisioni i Integritetit ka një produktivitet goxha konstruktiv dhe europian dhe duhet të merret shembull edhe nga komisionet e tjera, kjo falë edhe sensit të bashkëpunimit të kryetares dhe të tolerancës ndaj anëtarëve dhe të ftuarve.

Pyetja ime për zonjën Kashta: Në formën aktuale, ligji, në opinionin tuaj personal, si një person që keni punuar në atë institucion prej vitesh, a ju garanton mjaftueshmërisht dispozita ligjore për penalizime të forta ndaj atyre operatorëve, të cilët mund të shkelin kontratën ose mund të mos respektojnë termat e një kontrate apo pune të caktuar? Pra, a do të kishit dashur ju një penalizim më të fortë në ligj apo jo?

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Urdhëroni, zonja Kashta!

Kashta – Në mënyrën se si është parashikuar dhe si është formuluar ligji, unë mendoj se është i mjaftueshëm në arritjen e qëllimit të ndëshkueshmërisë, i shoqëruar gjithmonë me parimin e proporcionalitetit.

Sikurse e sqarova edhe herën e kaluar, prokurimi është proces dinamik dhe në thelbin e vet duhet të ketë parimin e proporcionalitetit. Nëse do ta konkretizoja, mund të kemi dy çështje të njëjta në keqzbatim kontrate nga operatorët ekonomikë. Nëse janë duke zbatuar një kontratë në vlerën 100 mijë lekë dhe janë duke e zbatuar apo moszbatuar një kontratë me vlerën

100 milionë lekë, këtu hyjmë me parimin e proporcionalitetit dhe masa e ndëshkimit do të duhet të jetë proporcionale. Pra, nuk kemi dhe nuk mund të kemi në një ligj një masë ekstreme ndëshkimi, sepse do të ndikonte edhe në frymën e përgjithshme, në politikën shtetërore, se si silllet ndaj tregut dhe një sjellje shumë agresive ndaj tregut do të na reflektonte në procedurat e radhës, një problematikë tjetër në të gjithë sistemin dhe në marrjen e produktit që ne duam.

Mendoj se bashkërenduar me parimin e proporcionalitetit masat ndëshkimore ndaj operatorëve ekonomikë në këtë ligj vijnë pak më të forta se në ligjin ekzistues, por janë të mjaftueshme dhe janë në logjikën e ndëshkimit, por edhe të mundësisë së ngritjes së përgjegjshmërisë, sepse ndëshkimi nuk do të ishte qëllimi i vetëm, përndryshe nuk do të marrim dot produktin e radhës në procedurën e radhës, nëse të gjithë do t'i ndëshkojmë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Faleminderit!

Zoti Gjoni, a jeni i qartë, apo doni të shtoni diçka?

Ralf Gjoni – Unë jam i qartë, por do të kisha dashur forma më të ashpra penalizimi, do të kisha dashur që ky projektligj, që besoj se është një hap në drejtimin e duhur, të kishte parashikuar edhe pozita më të gjëra për sa i përket kapaciteteve monitoruese të agjencisë.

Megjithatë, meqë është një hap në drejtimin e duhur, unë nuk do ta votoj kundër, por do të abstenoj dhe e deklaroj votën time abstenim për këtë ligj.

Faleminderit, zonjë kryetare!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Gjoni!

Besoj se këtu përfundon diskutimi me deputetët dhe me përfaqësuesit e APP-së.

Nëse nuk ka diçka tjetër nga deputetët, unë do të sugjeroja që të kalonim në votim.

Urdhëroni, zoti Kasneci!

Dedë Kasneci – Kam një sugjerim lidhur me procedurën, zonja kryetare.

Duke qenë se, sidomos riformulimi i pikës së fundit të nenit 127 është shumë thelbësor dhe sipas procedurës që përshkruan Rregullorja e Kuvendit, komisioni ynë është komision përgjegjës dhe sipas Rregullores, raporti i shkon komisionit përgjegjës, por në dijeninë time, komisioni përgjegjës e ka shqyrtuar dhe sot, pra e ka përfundur. Mirë do të ishte që, të paktën, në seancë plenare të ndiqej nga ana juaj dhe e deputetëve të tjerë, që këto ndryshime që ka raporti i Komisionit të Integritetit të përfshihen versionin final që do të miratohet në seancë plenare.

Rudina Hajdari – Urdhëroni, zonja Kashta!

Kashta – Komisioni i Ligjeve, që është komision përgjegjës, nuk e ka mbyllur ende. Ne kemi bërë një seancë ditën e mërkurë dhe kemi lënë dy nene të hapura, pra nuk kështë mbyllur miratimi në komisionin përgjegjës dhe ndoshta mund ta reflektojmë atje në seancën e radhës.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Darkord. Do t'ia çojmë Komisionit të Ligjeve të gjitha ndryshimet, amendimet, që keni rënë dakord.

Ne sot do të votojmë në parim dhe nen për nen me të gjitha ndryshimet që ka bërë zoti Kasneci dhe ka rënë dakord me zonjën Kashta dhe më pas do të votojmë në tërësi.

A jeni dakord me procedurën?

Dakord.

Atëherë, votojmë në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? 4 abstenime.

Faleminderit!

Votojmë nen për nen, bashkë me ndryshimet e zotit Kasneci.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? 4 abstenime.

Faleminderit!

Votojmë në tërësi projektligjin.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Dakord.

Faleminderit, të gjithë kolegëve për pjesëmarrjen!

Faleminderit, zonja Kashta, që erdhe edhe një herë në Komisionin e Integritimit!

Të gjitha ndryshimet, siç e thamë pak më parë, do t'ia dërgojmë komisionit përgjegjës, Komisionit të Ligjeve.

Kaq kishim për sot.

Ju uroj një fundjavë të mbarë!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA